REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E BUJQESISE

Nr._69 Prot **Bilisht më 20 /11 /2025**

PROJEKT-VENDIM

NR 69 DATE 20 / 11/2025

"PER MIRATIMIN E USHTRIMIT TE AKTIVITETIT BLEGTORAL BRENDA ZONAVE TE BANUARA TE BASHKISE DEVOLL"

Në mbështetje të neneve 32 dhe 54 te Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore'',I ndryshuar, të nenit 5 të Ligjit Nr.57/2025 " Për menaxhimin e integruar të mbetjeve ", te nenit 6 te Ligjit nr. 10279 date 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative'' Ligjit Nr.10138 datë 11.5.2009 "Për shendetin publik''I ndryshuar dhe Ligjit Nr.10465,datë 29.9.2011 ''Për shërbimin veterinar ne Republiken e Shqiperise" I ndryshuar.

Propozoj:

1-Ndalimin e ushtrimit të aktivitetit blegtoral brenda zonës urbane të Qytetit Bilisht si dhe në rrugët ose lagjet kryesore të të gjithë fshatrave të Bashkisë Devoll.

2-Të zbatohet si për aktivitetet familjare dhe për fermat blegtorale të cilët duhet ta zhvendosin këtë aktivitet jashtë zonave urbane në distancë 400 metër referuar Planit Urbanistik, Vendimit nr.283 datë 01.04.2015, i ndryshuar me VKM nr.373 datë 05.06.2024 ''Rregullat dhe kriteret e përgjithshme për ndërtimin për qëllimet bujqësore''.

3- Për zonat rurale duke qënë se ka specifika të veçanta këkojmë të ndiqet rast pas rasti nga personat e ngarkuar për zbatimin e këtij Vendimi.

4- Ndalimin e mbajtjes së kafshëve si dele, dhi, lopë, kuaj, derra brenda zones urbane të qytetit Bilisht dhe në rrugët kryesore apo lagjet me të populluara te disa fshatrave aty ku përbën problem për komunitetin.

5- Të gjithë blegtorët të cilët ushtrojnë aktivitet blegtoral brenda zonave te banuara, ti zhvendosin në zonat të përshtatshme në periferi të qytetit apo të fshatrave me qëllim shmangien e ndotjes si dhe të mos përdorin rrugët kryesore për kalim të tufave me bagëti ku aksesi i këmbësorëve është i lartë.

6- Të përfshihet i gjithë territori i banuar i qytetit Bilisht dhe rrugët kryesore të fshatrave përfshirë lagjet në kufirin e këtyre rrugëve.

7- Mbajtja e kafshëve brenda zonave të banuara përbën shkelje administrative dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi duke filluar nga gjobat deri te sekuestrimi i kafshëve.

8- Të lihet si afat kohor fermerëve të cilët ushtrojnë këtë aktivitet 1(një) vit kohë për të marë masa për zhvendosjen e këtij aktiviteti duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

9- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Bujqësisë, Policia Bashkiake dhe Administratotët e Njësive Administrative.

10- Ky vendim do të hyje në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55,pika 6 të ligjit nr. 139/2015 data 17.12.2015 ''Për vetëqeverisjen vendore''i ndryshuar.

Konceptoi: Prgj Sektori:

Maksi Hoxha

Miratoi: Drejtori:

Lisandri Cuko

Konfirmoi bazën ligjore: Përgjegjës I Sektorit Juridik dhe Prokurimeve

Eriksela Avdo

KRYETAR I BASHKISE DEVOLL

Eduard Duro

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DEVOLL

Adresa: Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 5; Tel+35581122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com;info@bashkiadevoll.gov.al Web:*http://bashkiadevoll.gov.al/*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E BUJQESISE

Nr. 3842 **Prot** **Bilisht më** 18/11/**2025**

Lenda: Relacion.

Mbi nevojen e miratimit te projekt-vendimit " per ndalimin e ushtrimit te aktivitetit blegtoral Brenda zonave te banuara te Bashkise Devoll".

1. Hyrje.

Ne Bashkine Devoll ushtrohet aktivitet blegtoral i shperndare ne te gjithe territorin, dhe ne deshirojme qe ky aktivitet te zhvillohet dhe te zgjerohet sepse sjell te ardhura per ata banore te cilet e ushtrojne dhe keto te ardhura jane burim jetese per ta. Por jane vene re disa problematika per te cilat ky relacion paraqitet para keshillit te Bashkise Devoll. Per te argumentuar nevojen e miratimit te projekt-vendimi i cili ka per qellim ndalimin e ushtrimit te aktivitetit blegtoral brenda zonave te banuara dhe zhvendosjen e ketij aktiviteti nga vete blegtoret ne zona periferike te pershtatshme per te mos perbere problem per komunitetin, sepse situata aktuale ne disa zona paraqitet mjaft shqetesuese.

2. Gjendja aktuale dhe problematikat qe ka sjell ky aktivitet.

Jane konstatuar nga strukturat e Bashkise Devoll te cilat jane te angazhuar me pune ne terren, raste mjaft shqetesuese te mbareshtimit te kafsheve brenda zonave te banuara si ne qytet Bilisht, po ashtu edhe neper fshatra, ne ambjente jo te pershtashme. Gjithashtu jane konstatuar levizje te bagetive neper rruge kryesore, lagje dhe zona te banuara si dhe tufa me bageti te imta te cilat kullosin ne tokat bujqesore te ndara me " Ligjin nr. 7501 Per Token".

Keto kane sjelle mjaft problematika si me poshte;

Ndotje e hapsirave publike , sepse bagetite te cilat pershkojne rruget lene pas mbetje organike dhe shperndajne aroma te pakendeshme per te cilat banoret qe preken nga kjo situate jane mjaft te indinjuar.

Kane rrezik per perhapje infeksionesh. Kjo per shkak te jashteqitjeve, pluhurit apo ndotjen e ujit. Kafshet mund te bartin baktere si E.Coli, Salmonella apo Leptospira e cila shperndahet nepermjet urines se infektuar dhe mund te kontaminoje ujrat dhe ambientin. Gjithashtu kafshet mund te bartin parazite te zorreve te cilet kontaminojne token dhe ujtrat. Mund bartin parazite te

jashtem si pleshtat tek dhite dhe kepushat te cilet atakojne drejtperdrejt njerzit dhe mund te transmetojne tek ta semundje.

Gjithashtu shumica e kafsheve mund te jene perhapese te shume semundjeve infektive te cilat sjellin probleme nqs kafshet mbareshtohen ne zona urbane.

Tjeter rrezik eshte dhe ndotja e ujit te pijshem sepse kafshet mund te kene akses ne ujembledhsa , apo ndotja e prodhimeve te fushes (fruta, perime).

Demtojne te mbjellat e fermerve. Kemi patur disa raste kur tufat me bageti te imta kane demtuar prodhimin (jonxhishtet , fasulet, te lashtat, dhe pemtarine).

Bllokojne qarkullimin dhe ne disa raste jane bere shkak per aksidente, sepse levizin ne rruge ku qarkullojne mjete transporti dhe levizja behet ne orare kur shikueshmeria eshte e ulet.

Demtojne hapsirat publike, kryesisht pemet dekorative apo siperfaqe te gjelberuara (lulishte) , sepse ushqehen me to.

Nevoja e kesaj nderhyrje .

Miratimi i ketij projekt-vendimi eshte i domosdoshem per te patur nje higjene me te mire, jete me komode per banoret duke shmangur ndotjen dhe aromat e pakendeshme. Gjithashtu jep me shume siguri persa i perket infeksioneve dhe rruajtjes se prodhimit te cilat i permendem me siper.

Baza ligjore.

Ky projekt-vendim mbeshtet ne:

Ligjin nr.139/2015 " Per veteqeverisjen vendore" , i ndryshuar

Ligjin nr. Nr.57/2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"

Ligjin nr. 10279 date 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative"

Ligjin nr 10 138, datë 11.5.2009 "Për shëndetin publik" i ndryshuar

Ligjin nr.10 465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

Ky vendim parashikon .

Ndalimin e mbajtjes se bagetive brenda zonave te banuara.

Vendosjen e masave administrative ne rast mos zbatimi te ketij vendimi.

Sekuestrimi ne rast perseritje.

Ngarkohen per zbatim .
Policia Bashkiake
Drejtoria e Bujqesise
Administratoret e Njesive Administrative

Si perfundim.
Miratimi i ketij projekt- vendimi eshte i nevojshem dhe i justifikuar

Konceptoi: Prgj Sektori,

M. Hoxha

Miratoi: Drejtori,

L. Cuko

Adresa: Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 5; Tel+35581122288; E-mail:
bashkiadevoll@gmail.com;info@bashkiadevoll.gov.al Web:*http://bashkiadevoll.gov.al/*